



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2021:117455

Datë: 24.06.2024

Numri i dokumentit: 05851912

P.nr.2021:117455

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC/Departamenti i Përgjithshëm–Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Mizahir Shabani, me bashkëpunëtorin profesional Afrim Gashi, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit D.P nga fshati Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Gjakovë/Departamenti Përgjithshëm PP/II.nr.739/2021 të datës 24.05.2021, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor dhe publik në prezencën e përfaqësuesit të akuzës Prokurori i Shtetit Qazim Xharra dhe i akuzuari, më datë 24.06.2024, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

I akuzuari,

D.P, nga i ati J dhe e ëma N, e lindur D, i lindur më dt...., në fshatin Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, ka të kryer shkollën fillore, i martuar, i ati i pesë (5) fëmijëve, i pa punë, gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e:

I. Nga data e pavërtetuar e gjerë me datë 07.04.2020, në shtëpinë e tij që gjendet në fshatin Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, me qëllim të përfitimit pasuror në mënyrë të kundërligjshme, ka shfrytëzuar energjinë elektrike në kundërshtim me nenin 61 të Ligjit për energjinë elektrike të Kosovës, nr.05/L-85, në vazhdimësi ka shfrytëzuar rrymën elektrike, në atë mënyrë që nga kontrollat e zyrtarëve të K, në datën e lartëcekur është konstatuar se i pandehuri, jashtë njehsorit elektrik me nr.32601194, përmes një kablllo është lidhur direkt në rrjetin elektrik, pa matje, duke anashkaluar kështu regjistrimin e saktë të energjisë së shpenzuar elektrike, me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar K-divizioni në Gjakovë, i ka shkaktuar dëm në shumën e përgjithshme prej 134.78 €.

II. Nga data 07.04.2020 e gjer me datën 21.05.2020, në shtëpinë e tij që gjendet në fshatin Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, me qëllim të përfitimit pasuror në mënyrë të kundërligjshme, ka shfrytëzuar energjinë elektrike në kundërshtim me nenin 61 të Ligjit për energjinë elektrike të Kosovës, nr.05/L-85, në vazhdimësi ka shfrytëzuar rrymën elektrike, në atë mënyrë që nga kontrolla e zyrtarëve tëK, në datën e lartëcekur është konstatuar se i pandehuri, jashtë njehsorit elektrik me nr.32601194, ka anashkalu kabllon furnizuese dhe përmes një kablllo është lidhur direkt në rrjetin elektrik, pa matje, duke anashkaluar kështu regjistrimin e saktë të energjisë së shpenzuar elektrike, me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar K-divizioni në Gjakovë, i ka shkaktuar dëm në shumën e përgjithshme prej 92.73 €.

III. Nga data 21.05.2020 e gjer me datën 25.06.2020, në shtëpinë e tij që gjendet në fshatin Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, me qëllim të përfitimit pasuror në mënyrë të kundërligjshme, ka shfrytëzuar energjinë elektrike në kundërshtim me nenin 61 të Ligjit për energjinë elektrike të Kosovës, nr.05/L-85, në vazhdimësi ka shfrytëzuar rrymën elektrike, në atë mënyrë që nga kontrolla e zyrtarëve tëK, në datën e lartëcekur është konstatuar se i pandehuri, jashtë njehsorit elektrik me nr.32601194, ka anashkalu kabllon furnizuese dhe përmes një kablllo është lidhur direkt në rrjetin elektrik, pa matje, duke anashkaluar kështu regjistrimin e saktë të energjisë së shpenzuar elektrike, me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar K-divizioni në Gjakovë, i ka shkaktuar dëm në shumën e përgjithshme prej 73.72 €.

IV. Nga data 07.04.2020 e gjer me datën 21.05.2020, në shtëpinë e tij që gjendet në fshatin Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, me qëllim të përfitimit pasuror në mënyrë të kundërligjshme, ka shfrytëzuar energjinë elektrike në kundërshtim me nenin 61 të Ligjit për energjinë elektrike të Kosovës, nr.05/L-85, në vazhdimësi ka shfrytëzuar rrymën elektrike, në atë mënyrë që nga kontrolla e zyrtarëve tëK, në datën e lartëcekur është konstatuar se i pandehuri, jashtë njehsorit elektrik me nr.32601194, përmes një kablllo 4x16mm është lidhur direkt në rrjetin elektrik, pa matje, duke anashkaluar kështu regjistrimin e saktë të energjisë së shpenzuar elektrike, me ç'rast ndërmarrjes së dëmtuar K-divizioni në Gjakovë, i ka shkaktuar dëm në shumën e përgjithshme prej 88.47 €.

-Këso dore ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të nenit 4, 6, 7, 17, 38, 39, 43, 69, 70, dhe 314 par.6 lidhur me par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, si dhe nenit 364 të KPPK-së, të akuzuarin e :

G J Y K O N

ME DËNIM ME GJOBË në shumën prej dyqind (200) Euro, të cilin dënim i akuzuari është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse i akuzuari nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, atëherë të akuzuarit dënimi me gjobë i zëvendësohet me dënim me burgim në kohëzgjatje prej dhjetë (10) ditëve, ashtu që për çdo ditë të kaluar në burgim do të llogaritet nga 20 (njëzet) €.

Detyrohet i akuzuari që të paguajë shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej tridhjetë (30), në afat prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

1.Ecuria e procedurës penale

Prokuroria Themelore në Gjakovë – Departamenti i Përgjithshëm, ka paraqitur aktakuzën PP/II.nr.739/2021 të datës 24.05.2021, kundër të pandehurit D.P nga fshati Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, për shkak të veprës penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së.

Gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit fillestarë me datë 24.06.2024, ku prezent kanë qenë përfaqësuesi i akuzës Prokurori i Shtetit Qazim Xharra dhe i akuzuari i cili është sjellur sipas urdhër arrestit, ndërsa nuk ka qenë prezent e të dëmtuara për të cilën gjykata nuk ka provë se është ftuar me kohë dhe në rregulle.

Pas leximit të aktakuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit i cila ka qëndruar në tërësi pranë saj, i akuzuari ka deklaruar se e ka kuptuar aktakuzën dhe ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues pasi është bindur se i akuzuari e ka kuptuar aktakuzën, të njëjtit i ka dhënë mundësinë e pranimit ose mospranimit të fajësisë dhe pasi i akuzuari e ka pranuar fajësinë, gjykata e ka njoftuar lidhur me efektet e pranimit të fajësisë. Po ashtu është kërkuar edhe mendimi i Prokurorit të Shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, Prokurori i Shtetit ka deklaruar se është i pajtimit me pranimin e fajësisë.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë.

I akuzuari ka deklaruar se e pranon fajësinë sipas të gjitha pikave të aktakuzës, e ndien veten fajtor për veprën penale për të cilën ngarkohet dhe se ndien keqardhje për rastin që ka ndodhur, është penduar për veprimin e bërë, dhe i premtoj gjykatës se një veprim i tillë nuk do të përsëritet, i propozoj gjykatës që të ketë mirëkuptim në shqiptimin e dënimit.

Prokurori i shtetit jep mendimin lidhur me pranimin e fajësisë i cili ka deklaruar se: nuk e kundërshton pranimin e fajësisë nga ana e të akuzuarit, pasi që pranimin e fajësisë e ka bërë me vullnet të lirë dhe pasi i ka kuptuar të drejtat, respektivisht favoret dhe pasojat e pranimit të fajësisë, po ashtu duke marrë për bazë se aktakuza ka mbështetje në provat materiale dhe personale në bazë të cilave është paraqitur gjendja faktike në dispozitiv të saj, ku edhe përmbushen të gjitha elementet e veprës penale për të cilat ngarkohet i akuzuari. I propozoj gjykatës që i akuzuar të shpallet fajtor dhe ti shqiptohet një dënim i paraparë ligjor duke pasur parasysh shkallen e përgjegjësisë dhe rrezikshmërisë së veprës penale për të cilën ngarkohet. Gjithashtu me rastin e vlerësimit dhe caktimit të dënimit të ketë parasysh edhe qëllimin e dënimit duke i vlerësuar rrethanat lehtësuese, pranimin e fajësisë në këtë shqyrtim fillestar, pendimin e tij, premtimin se ne te ardhmen nuk do të kryej ndonjë vepër penale ndërsa për rrethanat rënduese i lenë në vlerësim gjykatës.

Gjykata konform dispozitave të nenit 364 të KPPK-së, e pasi që janë plotësuar kushtet e parapara sipas dispozitave të nenit 322 të njëjtit Kod, për shkak se i akuzuari në fillim të seancës të shqyrtimit kryesor është deklaruar i fajshëm, në tërësi ka pranuar veprën penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata nuk është lëshuar në procedurën e administrimit të provave.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike: - se i akuzuari D.P, ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Në nenin 314 paragrafi 6 lidhur me paragrafin 1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, është parashikuar se formën themelore të veprës penale vjedhja e shërbimeve e kryen: **“Për qëllime të këtij neni, vjedhja e shërbimeve të gazit, ujit, rrymës ose ngrohjes përfshin, por nuk kufizohet në marrjen, përdorimin, devijimin, nxjerrjen ose përfitimin nga ndonjë shërbim i gazit, ujit, rrymës ose ngrohjes që furnizohet nga ose përmes rrjetit përçues të rrymës apo rrjetit të shpërndarjes, pa autorizimin e furnizuesit të autorizuar.”** po ashtu në paragrafin 1 parashihet se **“Kushdo që me anë të lajthimit, largimit ose mënyrave tjera siguron shërbime për të cilat dihet se mundësohen vetëm në shkëmbim të kompensimit dhe shmang pagesën për shërbime të tilla, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre (3) vjet”,** po ashtu në nenin 77 parashihet se **“Vepra penale në vazhdim përbëhet nga disa vepra të njëjta ose të ngjajshme të kryera në lidhshmëri kohore nga i njëjti kryes dhe të cilat paraqesin tërësi për shkak të ekzistimit të së paku dy prej kushteve në vijim: viktimës së njëjtë të veprës penale; objekti i njëjtë i veprës; shfrytëzimi i situatës apo marrëdhënjes së njëjtë kohore; vendi apo hapësira e njëjtë e kryerjes së veprës penale; ose dashja e njëjtë e kryesit.**

5. Vendimet e gjyqtarit të vetëm gjykues.

Gjyqtari i vetëm gjykues, pas pranimit të fajësisë nga i akuzuari, ka gjetur se i njëjti ka kryer veprën penale vjedhja e shërbimeve nga neni 314 par.6 lidhur me par.1 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, dhe gjendjen e tillë faktike e mori ashtu sikurse ishte përcaktuar në aktakuzë dhe provat të cilat i përmbante aktakuza, e të cilat janë:

-Raporti i kalkulimit të shpenzimeve të energjisë elektrike Sektori i Rikthimit të Humbjeve, nr.298277, datë 10.04.2020, nr.302822 të datës 26.05.2020, nr.307132 të datës 26.06.2020, nr.313602 të datës 07.08.2020;

-Fatura mbi dëmin e shkaktuar DGJHP209160 të datës 10.04.2020, DGJHP209220 të datës 26.05.2020, DGJHP209274 të datës 26.06.2020, DGJHP209335 të datës 07.08.2020;

-Procesverbal mbi konstatimin e gjendjes faktike me nr. 2527759 të datës 07.04.2020, nr. 0010586 të datës 21.05.2020, nr.0002085 të datës 25.06.2020, nr.0011208 të datës 06.08.2020;

-Foto dokumentacioni dhe shkresat tjera në lëndë.

Andaj duke u bazuar nga të lartëcekurat, gjykata ka ardhur në përfundim se në veprimet e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e veprës penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata ka vendosur ta shpallë fajtor dhe ta gjykojë në bazë të ligjit.

6. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit,

Me rastin e caktimit dhe matjes së dënimit gjykata ka marrë parasysh të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 69 dhe 70 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, ashtu që si rrethanë lehtësuese ka marrë sjelljen korrekte të të akuzuarit në gjykim, është penduar për veprimin e bërë, është hera e parë që ndeshet me ligjin, i njëjti është deklaruar i fajshëm, se i vjen keq për rastin e ndodhur, si dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsërisë një veprim të tillë, ndërsa rrethana veçanërisht rënduese gjykata nuk gjeti, andaj të njëjtit ia ka shqiptuar dënimin me kusht me shpresë dhe bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit të paraparë me dispozitat e nenit 38 të KPRK-së.

7. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit që kërkesën pasurore – juridike ta realizojë në procedurën e rregullt civile, bazohet në nenin 462 të KPPK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor bazohet në nenin 452 par.1 të KPPK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në vështrim të nenit 364 të KPPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.2021:117455, me datë 24.06.2024

B. Profesional
Afrim Gashi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Mizahir Shabani

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit nëpërmjet kësaj gjykate për gjykatën e Apelit në Prishtinë.